



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN KOSOVO
ODA EKONOMIKE AMERIKANE NË KOSOVË / AMERICKA PRIVREDNA KOMORA NA KOSOVO
ALTERNATIVE DISPUTE RESOLUTION CENTER
QENDRA PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE / CENTAR ZA ALTERNATIVNO RËSHIMJE SPORO



Kolegji ESLG

Memorandum Mirëkuptimi

Ndërmjet:

Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë - Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve dhe Kolegjit ESLG

Duke qenë të vetëdijshëm mbi dobitë e Metodave Alternative të Zgjidhjes së Kontesteve për komunitetin e biznesit, ndikimin në mjedisin biznesor të vendit, dhe nevojës së promovimit të tyre në Kosovë;

Me qëllim të promovimit të një ambienti akademik më dinamik dhe përgatitjes së gjeneratave të ardhshme të profesionistëve në fushën e Zgjidhjeve Alternative të Kontesteve, veçanërisht në arbitrazh dhe ndërmjetësim;

Duke qenë të vetëdijshëm se Metodat Alternative të Zgjidhjes së Kontesteve janë pjesë e zakonshme e kurrikulumeve të Universiteteve ku edhe zënë një vend me rëndësi, veçanërisht arbitrazhi dhe ndërmjetësimi si pjesë e mësimin klinik;

Me qëllim të promovimit të punës dhe kapaciteteve të Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, dhe rritjes së numrit të kontesteve që zgjidhen përmes Metodave Alternative;

Me qëllim të krijimit të një platforme të bashkëpunimit në mes të akademisë, Qendrës ZAK, dhe komunitetit të biznesit;

Duke besuar se zhvillimi i mëtutjeshëm i arbitrazhit dhe ndërmjetësimit në Kosovë është në dobi të përbashkët për të dy palët e këtij memorandumi, dhe me mbështetjen e Iniciativës "Forward" të USAID;

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (Qendra ZAK), Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, dhe Kolegji ESLG pajtohen si më poshtë:

A. Objektivi i memorandumit

1. Memorandumi i Bashkëpunimit ka si qëllim përcaktimin e parimeve të bashkëpunimit dhe obligimeve respektive në zhvillimin e Zgjidhjeve Alternative të Kontesteve në Kosovë, dhe realizimin e benefiteve të dyanshme nga zhvillimi i këtij sistemi në Kosovë.
2. Palët pajtohen që të bashkëpunojnë në mirëbesim dhe të shfrytëzojnë avantazhet respektive, në një rën anë si asociacion i bizneseve, dhe në anën tjetër si institucion akademik, për të punuar drejt arritjes së synimeve të parashikuara në pjesën hyrëse të këtij memorandumi.

B. Përgjegjësitë e Kolegjit *ESLG*

1. Kolegji *ESLG* do të ofrojë lëndë mësimore në fushën e zgjidhjes Alternative të Kontesteve, duke përfshirë arbitrazhin dhe ndërmjetësimin.
2. Kolegji do të angazhohet në organizimin e mësimit klinik përmes stimulimit të punës së tribunaleve të arbitrazhit përmes rasteve hipotetike. Në këtë drejtim Qendra ZAK do të ofrojë ekspertizën e saj dhe do të ndihmojë në dizajnimin e programit dhe ofrimin e ligjëratave të ndryshme.
3. Kolegji do të inkurajoj stafin akademik dhe studentët që të kontribuojnë në revistën shkencore për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve që do të publikohet nga Qendra ZAK, dhe në revista tjera shkencore;
4. Universiteti (Kolegji) do të përfshijë modelin e klauzolës së arbitrazhit të Qendrës ZAK në marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta. Një klauzolë e tillë lexon:

“Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga apo në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë shkëljen, ndërprerjen ose jo-vlefshmërinë e kontratës, palët pajtohen që fillimisht të provojnë ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë në pajtim me rregullat e Ndërmjetësimit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Nëse nuk arrihet marrëveshje brenda 30 ditëve, apo ndërmjetësimi dështon më herët, palët do ta zgjidhin rastin përmes arbitrazhit pranë Odës Ekonomike Amerikane në pajtim me rregullat e Arbitrazhit në fuqi.”

C. Përgjegjësitë e Qendrës ZAK, Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës

1. Të konsiderojë përfshirjen e studentëve të suksesshëm të cilët ndjekin kurset për Zgjidhjet Alternative të Kontesteve brenda Kolegjit *ESLG* në listën e asistentëve dhe hulumtuesve profesional të cilët do të sugjerohen për të ndihmuar arbitrat dhe ndërmjetësuesit në rastet të cilat menaxhohen nga Qendra ZAK. Përzgjedhja e tyre është kompetencë ekskluzive e arbitrave dhe ndërmjetësuesve, dhe asistentët dhe hulumtuesit nuk konsiderohen pjesë e listës zyrtare të arbitrave dhe ndërmjetësuesve të Qendrës ZAK.

2. Të përfshijë studentët e interesuar në grupin e arbitrave dhe ndërmjetësve të rinj të Qendrës ZAK, dhe tu ofrojë atyre benefitet sikurse janë paraparë me program. Përfshirja në grupin e arbitrave dhe ndërmjetësuesve të rinj nuk ndikon në listën zyrtare të arbitrave dhe ndërmjetësuesve të Qendrës ZAK, të cilat plotësohen në bazë të kriterëve të ndryshme.
3. Të ofrojë trajnime profesionale për studentët, duke përfshirë databazat profesionale në arbitrazh dhe ndërmjetësim.
4. Të mundësojë pjesëmarrjen e studentëve në tryeza, konferenca apo trajnime tjera profesionale të realizuara nga Qendra ZAK për anëtarët e Odës Amerikane të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të Odës, arbitrat, ndërmjetësuesit dhe tjerë.
5. Të organizojë takime rrjetëzuese mes studentëve të fokusuar në fushën e Zgjidhjes Alternative të Kontesteve dhe kompanive anëtare të Odës Ekonomike Amerikane.
6. Të ofrojë qasje për studentët në librarinë dhe resurset tjera profesionale të Qendrës ZAK për qëllime të hulumtimeve tyre shkencore dhe profesionale.
7. Të organizojë ligjërata publike me studentë me ekspertë të ndryshëm.

D. Shpenzimet

1. Përmbushja e angazhimeve të parashikuara me këtë Memorandum Bashkëpunimi do të bëhet me shpenzimet vetanake të dy institucioneve, dhe memorandumit nuk krijon obligime për kompenzime nga ana tjetër.
2. Për projekte tjera shtesë, apo angazhime tjera të cilat kanë implikime financiare të dyanshme, do të ketë marrëveshje apo kontrata të veçanta me shkrim.

E. Tërë marrëveshja mes palëve

1. Ky memorandum përfaqëson tërë atë për të cilën janë pajtuar palët.
2. Ky memorandum është shprehje e vullnetit të mirë për bashkëpunim për arritjen e qëllimeve të përbashkëta dhe nuk krijon obligime dhe përgjegjësi ligjore në lidhje me angazhimet të cilat lindin nga përmbushja e tij, duke përfshirë edhe shpenzimet financiare, me përjashtim të kushtit të përfshirjes së klauzolës së arbitrazhit në kontrata nga ana e Kolegjit.

F. Amandamentimi i memorandumit

1. Ky memorandum bashkëpunimi mund të ndryshohet me pajtimin e dy palëve, dhe ndryshimet e tilla duhet të bëhen me shkrim.

G. Njoftimet

1. Çdo njoftim apo komunikim në lidhje me këtë memorandum do të bëhet nëpërmjet palëve të mëposhtme:

Për Qendrën ZAK, Oda Ekonomike Amerikane – Visar Ramaj, Sekretar Gjeneral

Visar Ramaj

Sekretar Gjeneral

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve

Adresa: Perandori Justinian No. 16, 10000 Prishtina, Kosovë

Tel: +377 44 210 889 / E-mail: visar.ramaj@amchamksv.org

Për Kolegjin **ESLG**- Visar Hoxha, President i Kolegjit ESLG

Visar Hoxha

President i Kolegjit ESLG

Kolegji ESLG, Fakulteti Juridik

Adresa: College ESLG, Veternik p.n. 1000 Prishtina, Kosovo


Tel: +377 45 456 666 / E-mail: visar.hoxha@eukos.org

2. Në rast të ndryshimeve të personave kontaktues, njoftimi do t'i përcillet palës tjetër në afat brenda 10 ditësh.

Kjo marrëveshje është lidhur në dy kopje origjinale, dhe versioni origjinal është në gjuhën shqipe.



Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve
Visar Ramaj
Sekretar Gjeneral i Qendrës ZAK



Fakulteti Juridik, Kolegji ESLG
Dr. Visar Hoxha
President i Kolegjit ESLG

